



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM NR 117 Datë 22.11 .2019

“Për përdorimin e fondit nga projekti “”Askush të mos mbetet pas” me UNDP

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr 109/2017“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.05 datë 29.01.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.183/1 prot. Datë 07.02.2019: Këshillit Bashkiak, në mbledhjen e tij, datë 22.11.2019 miratoi me 22 vota pro

VENDOSI:

1. Në bazë të marrëveshjes standarte që do të miratohet nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër, mes programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Dibër mbi zbatimin e programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese, kërkojmë që shuma e projektit fitues me vlerë 1.988.010 lekë, e cila do kalojë në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Dibër sipas marrëveshjes, të përfshihet në Buxhetin e Bashkisë Dibër në strukturën 10140/5. Ky projekt-vendim duhet që të zbatohet brenda kushteve të marrëveshjes e cila do çelet me 3 këste 4-mujore sipas pikës së marrëveshjes dhe do të pasqyrohet në buxhetin vjetor të Bashkisë Dibër, e cila do të zbatohet për çdo transferim fondi që do të bëjë UNDP.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Personelit dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

Sekretare e Këshillit Bashkiak

Inva TRUPJA

Kryetar Këshilli Bashkiak

